



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr. 28/15 qershor 2008), të dispozitave të nenit 5 të Ligjit nr 08/L- 224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L- 005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 07.12.2023, merr këtë:

V E N D I M
PËR FALJEN E TATIMIT NË PRONËN E PALUAJTSHME
PËR VITIN TATIMOR 2023

1. MIRATOHET Vendimi për faljen e tatimit në pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023.
2. Falja e tatimit në pronën e paluajtshme vlen për të gjithë tatimpaguesit e Kryeqytetit për vitin tatimor 2023.
3. Shuma për faljen e tatimit në pronën e paluajtshme do të jetë jo më shumë se 75,00 euro (shtatëdhjetë e pesë euro).
4. Në rast se tatimpaguesit kanë paguar faturën e tatimit për pronën e paluajtshme për vitin tatimor 2023, shuma e falur llogaritet si paradhënie për vitin 2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Financave – Sektori i tatimit në pronë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-414/04-230385/23, më 08.12.2023

KRYESUESJA E MBLEDHJES SË KUVENDIT
Nora Kelmendi

